



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.9/24
Prishtinë, më 8.5.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, kryetar, Mërgim Lushtaku, nënkryetar, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Ferat Shala dhe Pal Leka, anëtarë.

Të ftuar: Jeton Raka–zv.ministër-MMPHI, Dëfrim Pllashniku, keshilltar politik-MMPHI, Zanita Halimi, kryetare –KKTK, Sadik Krasniqi, anëtar -KKTK, Ifeta Nikoliq, anëtare –KKTK, Sllagjana Boshkoviq, anëtare-KKTK, Afrim Buqinca, nënkryetar - KKTK, Premtim Alaj, anëtar -KKTK, Kreshnik Bajraktari, zv.udhëheqës ekzekutiv –KKTK.

Pjesëmarrësit tjerë: Driada Thaqi, zyrtare për Bashkëpunim -ZKA, Naim Jakupi, Menaxher i programit- IKD, Diar Beqaj, praktikant - D+, Medina Ismajli, D+, Valjeta Shala, Gazetare-RTK, Sami Gashi- GP-LVV, Elsa Krasniqi-GP-LVV, Nexhmije Ahmeti, zyrtare e mediave- Kuvendi i Kosovës, Festim Bytyqi, GP-AAK, Valmire Abdullahu, gazetar – EO.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rëndit të ditës;
2. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-299 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj;
3. Votimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave;
4. Votimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin 08/L-207 për Tekste Shkollore;
5. Votimi i raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023;
6. Votimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022 dhe 2023;
7. Votimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe 2023;
8. Votimi i raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2022 dhe 2023;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes për Projektligjin së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat”;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-303 për ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim(“Marrëveshja”) - neni 1;
11. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2025-2027;
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2023;
13. Të ndryshme.

1. Miratimi i rëndit të ditës;

Kryetari: Para se të vendos rendin e ditës në votim, propozoj që si pikë shtesë e rendit të ditës të jetë edhe shqyrtimi i raportit me rekomandime i Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri.

Eman Rrahmani: Para se të votohet rendi i ditës, propozoj që pika 4 të hiqet prej rendit të ditës, e cila ka të bëjë me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin 08/L-207 për Tekste Shkollore, përndryshe nuk do të marrë pjesë në votim për miratimin e rendin e ditës.

Kryetari: Projektligjit 08/L-207 për Tekste Shkollore, i ka kaluar afati për votim, ne si Komision nuk do të dërgojmë rekomandim, kështu që kjo pikë hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari pas votimit konstatoi se me shumicë votash u miratua rendi i ditës, me ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri

Kryetari: Projektligjin nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri, është shqyrtuar nga Komisioni Funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente. Në bazë të deklaratës së Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, vlerësohet se Projektligji nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri, përmban implikime buxhetore shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës, në shumë prej 1,445,800 euro për periudhën 2023 - 2025, këto mjetë që nuk janë të planifikuara me vlerësimet buxhetore për vitet 2023/2025. Po ashtu, më këtë projektligj parashihet edhe numri shtesë i punëtorëve për 14 pozita.

Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, Projektligjin nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mergim Lushtaku: Ne duhet ta kemi te qartë se për çka specifikisht bëhet fjalë në këtë projektligj, a vetëm për 14 pozita të reja, apo ka të bëjë edhe me investime kapitale, siç është blerja e makinerisë për fikjen e zjarrit, apo jo?

Eman Rrahmani: Kur kemi projektligje me implikime buxhetore, duhet të ftohet edhe propozuesi të jep sqarime nga do t'i marrin këto mjete. Ne si Komision duhet të bëjmë praktikë që t'i ftojme sponsoruesit dhe të na sqarojnë për implikimet buxhetore.

Kryetari, pas përfundimit të diskutimit, e hodhi ne votim dhe konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë rekomandim për Komisionin funksional:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri përmban implikime buxhetore shtesë, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, për Projektligjin nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
3. **Votimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional Mjedis, Ushqim Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave;**

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më 24 prill 2024, andaj sot e vendosim në votim raportit me amendamente të Komisionit funksional Mjedis, Ushqim Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave

Kryetari, Pasi nuk pati të paraqitur për diskutim dhe pas votimit, konstatoi se komisioni nxori rekomandim për Komisionin funksional si vijon:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave nuk përmban implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, për Projektligjin nr. 08/L-242 për performancën energjetike, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

4.Votimi i Projektligjit nr. 08/L-299 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për Projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj;

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit me datë 24 prill 2024, andaj sot e vendosim në votim raportin. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për Projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj dhe Kuvendit i paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 08/L-299 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj.

5. Votimi i Raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023;

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më datë 24 prill 2024, andaj sot e vendosim në votim raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022, pas votimit kryetari konstatoi se me shumicë votash komisioni, për Komisionin Funksional nxjerr këtë :

Raport

Miratohet Raporti vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022.

6. Votimi i Raportit Vjetor Financiar i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe 2023;

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit me datë 24 prill 2024, andaj sot e vendosim në votim raportin vjetor Financiar të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022.

Pas votimit, kryetari konstatoi se me shumicë votash komisioni, për Komisionin FunkSIONAL nxjerr këtë :

Raport

Miratohet Raporti vjetor financiar i Agjencisë për parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022.

7. Votimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022 dhe 2023;

Kryetar: Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit me datë 24 prill 2024, andaj sot e vendosim në votim raportin vjetor financiar të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022, i cili miratohet me shumicë votash.

Raport

1. Miratohet raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022

8. Votimi i raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2022 dhe 2023;

Kryetari: Ju njoftoj se edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit me datë 24 prill 2024, andaj sot e vendosim në votim raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2022.

Pas votimit, kryetari konstatoi se me shumicë votash komisioni, për Komisionin FunkSIONAL nxjerr këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2022.

Kryetari sqaroi se raportet financiare të Institucioneve të lartpërmendura për vitin 2023, do të votohen pasi që të pranojmë edhe raportet e Audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat.

Kryetari: Për këtë pikë kemi diskutuar javën e kaluar me ministrin Murati, i cili e ka arsyetuar Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat, por më kërkesën e deputetëve kemi ftuar dhe ministrin e Infrastrukturës për sqarime shtesë, për çështje të caktuara.

Jeton Raka: Kjo marrëveshje të kredisë, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, për projektin e banimi social adekuat është një hap drejt mirëqenies së qytetarëve për zgjidhjen e çështjes së banimit për kategoritë sociale dhe familjet e varfëra. Me dt 25.1.2024, ministri i Financave dhe Guvernatori i Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar marrëveshjen e përgjithshme të huas në shume prej 25 milionë euro për ngritjen e numrit të njësive të banimit social në vend. Me këtë rast, marrëveshja përfshin disa komponentë kyç për arritjen e qëllimit të projektit. Në kuadër të kësaj, përfshihet ngritja e numrit të njësive të banimit social, që mund të bëhet duke rinovuar banesat sociale ekzistuese, shndërrimin e ndërtesave ekzistuese në banesa të reja sociale. Nga marrëveshja përfshihen dy komponentë: komponenti i parë, është rritja e njësive të numrit të banimit sociale, që të bëhet renovimi i banesave sociale ekzistuese, apo shndërrimin e banesave ekzistuese në ndërtesa të reja sociale. Komponenti i dytë është renovimi dhe ndërtimin i shtëpive individuale për familjet e varfëra dhe me të ardhura të ulëta. Projekti do të zbatohet përmes thirrjes publike të komunave dhe gjithçka do të jetë transparente. Sipas ligjit në fuqi komunat i kanë të hartuara programet 3 vjeçare të banimit ku janë të identifikuar nevojat e qytetarëve për banim në komunat e tyre, si dhe identifikimi i lokacioneve se ku mund të ndërtohen banesat sociale për njerëzit në nevojë. Kushtet janë të përcaktuara në manualin që është duke u hartuar me asistencë teknike nga Wviaefit. Një grand prej 2 milion euro e kemi të fituar, dhe sipas analizës që është bërë për këtë projekt janë ofruar marrëveshjet e mirëkuptimit midis Ministrisë së Financave dhe Komunave përkatëse.

Eman Rrahmani : Sa i përket kësaj marrëveshje, jemi të informuar nga ministri Murati, mirëpo, ndoshta është dashur me qenë këtu edhe ministri Libur Aliu, për të raportuar dhe arsyetuar këtë marrëveshje, meqë duhet të miratohet kjo kredi prej këtij komisioni, përndryshe e di që janë publikuar rezultatet e atij studimit të fizibilitetit për këtë projekt.

Sa shtëpi dhe banesa kanë me u ndërtuar dhe sa kanë më u rinovuar? Duhet të keni statistika të sakta për shkak se keni marrë një huamarrje kaq të madhe dhe duhet ta dimë saktë koston e mjeteve për ndërtim. apo rinovimit të objekteve, pra na duhen me shumë informacione. A do të ketë ndërtime individuale apo vetëm ndërtime kolektive?

Jeton Raka: Është hartuar një studim i fizibilitetit në vitin 2022 për banim social, i cili është financuar nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës dhe projekti Italian për fonde inovative dhe është zbatuar nga Habitati. Ky studim shërben si bazë për Draft-ligjin dhe rekomandimet e tij për banim social dhe është i përballeshëm për buxhetin e Kosovës. Të dhënat e sakta përcaktohen në manualin e zbatimit të këtij projekti, në vitin 2022 Ministria i ka kërkuar Komunave plotësimin e një formulari se sa janë të gatshëm për këtë projekt, prej tyre 9 komuna kanë dorëzuar lokacion për banim social, ato janë Deçani, Dragashi, Drenasi, Malisheva, Jugu i Mitrovicës, Peja, Podujeva, Prizreni dhe komuna e Artanës, ndërsa 10 komuna kanë nevojë për rinovimin për banesat me banim social apo shtëpi.

Eman Rrahmani: Këto banime kolektive a kanë me qenë vetëm rastet sociale, a po të shpërndara, ashtu siç është në plan programin tonë dhe a ka të bëjë vetëm me banimin sociale, apo dhe me banimin e përballeshëm?

Jeton Raka: Sa i përket kësaj nuk duhet t'i ngatërrojmë këto dy koncepte për banim social edhe të përballeshme, banimi social është marrëveshja që është bërë me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe ne si Ministri jemi participues me 11 milionë euro, ndërsa Banka Cep është me 25 milionë euro, kjo ka të bëjë vetëm me banimin social, e jo me banimin të përballeshëm. Deçani i ka 4 kërkesa, Drenasi, 50 kërkesa, dhe ne duhet i rishikojmë këto.

Eman Rrahmani: Sa i përket kësaj marrëveshjeje, sa është vlera e koston financiare për rindërtim apo rinovimin e shtëpive apo banesave në Komunën e Deçanit apo ndonjë komunë tjetër, sepse pa

një projekt të detajuar dhe vlerën e saktë të kostos nuk mund të merrni kredi nga asnjë bankë. A e keni shifrën për njësitë e banimit, çfarë shtëpishë do të ndërtohen, kush ka për të përfituar prej tyre, sa banesa kanë me u ndërtua në Komunën e Deçanit, apo të Prishtinës, si kanë më qenë ndërtimet, a kanë me qenë ndërtime kolektive apo të shpërndara, në mënyre që mos t'i getoizojmë, pra në ato ndërtesa të ketë edhe qytetar të tjerë, por jo vetëm rastet sociale?

Jeton Raka: Fillimisht do të bëhet njësi i menaxhimit të projektit dhe njësitet implementuese të projektit për komuna dhe këto njësi do të punojnë bashkë për projektin kryesor, pastaj mund të vijmë tek shumica e saktë e vlerësimeve. Qytetari ka me përfitua çështjen e banimit ka me përfitua në renovim e shtëpive të vjetra dhe banesave.

Kryetari: Shqetësimi i z. Rrahmani është edhe i imi sepse nuk mundeni me i nda se ke lindur i varfër edhe do te mbetesh përjetësisht i varfër dhe duhet te jenë të gjithë të barabartë pa i paragjykuar ato familje, por për këtë pjesë na duhen informacione shtesë ose me shkrim.

Duda Balje: Unë jam deputete nga komuniteti dhe ka më shumë se 15 vjet që merrem me banim social dhe jemi munduar me e realizua këtë lloj projekti për te cilin jeni duke e bërë ju ligjin. Ju e keni dërguar nëpër komuna projektin por komuna i kanë specifikat e veta secila prej tyre, pra duhet me i caktuar kushtet sepse familjet e varfra kanë shumë dallime prej njëra- tjetrës si p.sh. familjet e varfra që kanë jetimë, familje me aftësi të kufizuara, dhe nëse nuk e bëni një kategorizim më këto familje se di se si ja dilni. Banimin kolektiv jeni duke e bere individual a po jo, secili prej tyre duhet ta ketë tokën dhe familjet, të cilat nuk kanë tokë të tyre, nuk aplikojnë. Familjet duhet ta kenë tokën e vet në emrin e vet që Komuna t'i sigurojë një banim, ata janë duke banuar me qira dhe nuk kanë tokë. Komuna nuk jep tokë dhe çfarë mund të ndërmerret për këtë çështje, pra ky proces është shume i komplikuar dhe duhet të jeni shume të kujdesshëm gjatë realizimit të tij.

Kryetari : Ju sugjeroj që të bashkëpunoni me deputeten Balje, pasi që 15 vite merret më këtë çështje dhe po ashtu, duhet t'i keni parasysh edhe komunitete jo shumicë qe mos të lihen anash në këtë projekt .

Avdullah Hoti: Sa i përket kësaj marrëveshjeje, duhet ta kemi të qartë dhe të informohemi saktë, ne si deputetë kemi kërkuar sqarime prej ministrit te financave edhe ministrit të infrastrukturës, sepse disa prej çështjeve që unë i kam, nuk e di a mund të marr përgjigje prej juve zv. ministër. Disa kolegë i preken disa çështje që desha t'i parashtojë, por nuk morën përgjigje adekuate. E keni marrë si koncept ide, pra keni marrë një kredi pa dhënë detaje të këtij projekti. E kam analizuar marrëveshjen dhe te shtojca thuhet se kjo është e miratuar në Këshillin Administrativ të Bankës Zhvillimore, më 18 nëntor të vitit 2022 dhe është nënshkruar vetëm në janar të vitit 2024, pse është vonuar nënshkrimi i saj nga ministri i financave, a ka ndonjë arsye?

Jeton Raka: Nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës është kërkuar që të bëhet studimi i fizibilitetit dhe pa këtë studim s'ka nënshkrim të marrëveshjes dhe studimi i fizibilitetit është bërë në vitin 2022 dhe besoj se ju keni njohuri rreth kësaj çështjeje, sepse e përmende, se pse është bërë marrëveshja, e pse është bërë kredia, sepse në një dokument që e kam unë, të datës 15.2.2017, është e nënshkruar nga ju, sa keni qenë ministër i Financave, ku keni kërkuar kredi. Kjo kredi është kërkuar në vitin 2017, prej juve, z. Hoti.

Avdullah Hoti: Pika që po diskutojmë është për studimin e fizibilitetit, që është kërkuar nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës. Kredia është aprovuar në nëntor te vitit 2022, por pse është vonuar të nënshkruhet deri në janar të vitit 2024? Te pika 2, shndërrimi i shtëpive ekzistuese në banesa të reja sociale të përbalueshme, unë kam punuar edhe në pushtete lokale e nuk e di se ku ka banesa në pronësi të shtetit. Hoti theksoi se nëse shteti mund t'i marrë banesat private e t'i shndërrojë në banesa sociale dhe t'iu jepen familjeve në nevojë, nuk e di se çfarë thuhet në studimin e juaj të fizibilitetit për këtë çështje. Te pjesa e

shtojcës, buxheti total është 45 milionë, pagat janë 3 milionë euro dhe ngritja e sistemi për zbatimin e projektit është 2 milionë euro, që në total 11.1% e buxhetit do të shpenzohet për paga dhe për ngritje të sistemit të projektit. Kalendarin e punimeve është 2023 -2031, prandaj pyeta me plot të drejtë, pse marrëveshja nuk është ratifikuar ende në Kuvend? Prandaj, afati 2023-2031 nuk vlen, pra nuk është i zbatueshëm. Kam pyetje të shumta, por nuk mund ta diskutojmë pa qenë ministri i Financave, sepse po e shoh se zëvendësministri i Infrastrukturës nuk ka përgatitur të duhur që të përgjigjet për këtë projekt të rëndësishëm.

Visar Korenica: Mendoj se është dashur me qenë ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në takim për çështjet që janë ngritur. Ne kemi kërkuar kohë shtese për këtë projekt, në mënyrë që të informohemi në detaje, sepse është një projekt shumë i rëndësishëm. Çka nëse komunat nuk dërgojnë kërkesa të sakta, a ka plan B Qeveria? Çka nëse nuk bëhet ndarja e barabartë apo e drejtë e implementimit të projektit, a janë marrë masa që të përfshihen në mënyrë të drejtë e të barabartë të gjitha familjet në nevojë në rajonet e Kosovës? Kjo është dashur të merret parasysh gjatë studimit të fizibilitetit. Çka nëse dalin probleme ndërkohë? Çfarë hapash keni ndërmarrë, që shpërndarja e këtij projekti të jetë i barabartë, dhe sa i përket getoizimit, a e keni paraparë këtë problem gjatë implementimit të projektit?

Jeton Raka: Sa i përket ligjit për programe të veçanta të banimit social, komunat kanë përgjegjësi të hartojnë programe 3- vjeçare për banimin social dhe është obligim ligjor që komunat në bazë të këtyre raporteve të dalin edhe me rezultate për çështjet që i ngritët. Janë 17 komuna, të cilat i kanë këto programe 3- vjeçare të banimit social, por 7 prej tyre janë që iu kanë skaduar programet, por e kanë obligim ligjor që prapë të hartojnë programe. 3 komuna i kanë programet si draft, ndërsa 10 komuna nuk kanë hartuar fare programe, ndër to janë: Dragashi, Juniku, Kllokoti, Leposaviqi, Mamusha, Mitrovica veriore, Parteshi, Prishtina, Zubin Potoki dhe Deçani. Sa i përket getoizimit, nuk do të ketë getoizim, do të ketë një kombinim me banimin e përballeshëm, brenda një kati të banesës, do të ketë familje të ndryshme dhe një kategori sociale, me qëllim të integritit më të mirë të atyre familjeve.

Visar Korenica: Në bashkëpunim me komunat, shihet se 17 prej tyre nuk kanë bërë kërkesë, sepse nuk paskan nevojë për banim social apo jo. A po e vëreni se nuk mund të bazoheni në kërkesat e komunave, sepse nuk janë të sakta? Çfarë është plani i Qeverisë për të përmyllur pjesën tjetër të hapësirës, ku komunat nuk janë të përfshira, si do të vepronin në ato komuna që nuk kanë bërë kërkesa për çështjen e banimit social?

Jeton Raka: Ashtu siç e theksova, komunat kanë obligim ligjor që të hartojnë programe dhe programet t'i dorëzojnë në Ministrinë e Financave, sepse pa hartimin e programit nga komunat, nuk mundem të bëjmë banim social në atë komune, pra është obligim ligjor. Nëse komuna nuk ka pronë për banim social, Qeveria është ajo që duhet të shikojë se ku ta gjejë parcelën për këto banesa apo shtëpi për banim social.

Duda Balje: Ne jemi ata që e ndryshojmë ligjin dhe unë kisha propozuar që të dilet me ndonjë propozim konkret. Kjo është në të mirë të qytetareve tanë. Zgjidhja e çështjes së banimit social për secilën familje është shumë e rëndësishme, mirëpo ne duhet ta ndryshojmë ligjin dhe të bëjmë më të mirën e mundshme për banim social. Më mirë është për të dalë me një propozim konkret, që të kontribuojmë për këto familje. Ministria e Mirëqenies Sociale ka data-bazë, se sa familje nuk kanë prona në emër të tyre dhe t'u ndihmohet.

Kryetari: Të gjitha çështjet që u parashtruan këtu nga deputetët, është obligim i juaj, që t'i jepni të gjitha informacionet që përfshihen në projekt dhe për t'i bindur deputetët, sepse kjo marrëveshje do të votohet në Kuvend.

Jeton Raka: Informacionet që i keni kërkuar do t'ua sjellim me shkrim, mirëpo për të kundërshtuar marrëveshjen vetëm se kemi arritur ne si Qeveri ta sjellim deri tek implementimi, e të tjerët para neve nuk kanë arritur këtë ta bëjnë, sepse kjo ka një historik, pra kjo ka filluar më herët.

Kryetari: Është një projekt shumë me rëndësi për të gjithë ne dhe ky projekt që është filluar në vitin 2017, është shqetësim i njëjtë për të gjithë ne. Pra, është një projekt i rëndësishëm, që të punojmë për këtë grup shoqërore dhe çfarëdo kërkesë që keni për informata shtesë, ju lutem, përcillni në komision, sepse të gjitha kërkesat që u parashtruan këtu, janë të arsyeshme.

Avdullah Hoti: Sa i përket marrëveshjes, ne si grup parlamentar, gjithmonë i kemi mbështetur marrëveshjet. Vetëm nëse ka qenë ndonjë çështje kapitale, vetëm në dy marrëveshje kemi pasur vërejtje kapitale e nuk i kemi votuar. Në këtë marrëveshje nuk kam vërejtje kapitale, por ne nuk mund të votojmë në Kuvend e pastaj t'i marrim përgjigjet më vonë. Unë, grupin parlamentar nuk mund ta informoj saktë për këtë marrëveshje, sepse nuk e kam të qartë as vetë, sepse për pyetjet që i ngrita nuk mora përgjigje të duhur.

Kryetari: Sa i përket kësaj marrëveshjeje, është shumë e rëndësishme për ne. I kuptoj shqetësimet e juaja, por konsensusi lypet nga të gjitha grupet parlamentare, kishte qenë mirë, që debati të shterohet këtu në komision. Sugjerimi juaj është që të ketë edhe një takim të radhës. Pyetjet t'i bëjmë me shkrim dhe t'iu mundësojmë atyre, që të vijnë të përgatitur dhe ne si pikë të rendit të ditës, ta vendosim për mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-303 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim(“Marrëveshja”) - neni 1

Kryetari: Në bazë të nenit 83, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare e shqyrton Komisioni përgjegjës-raportues. Qeveria e Republikës së Kosovës ka proceduar Projektligjin nr.08/L-303 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim- neni 1. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe të paraqesë raportin me rekomandime në Kuvend. Për të arsyetuar Projektligjit nr.08/L-303 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim– neni 1, kemi ftuar ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Muratin.

Hekuran Murati: Republika e Kosovës është anëtarësuar në Bankën Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim në nëntor të viti 2012, është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për themelimin e BERZH-it në Kosovë. Ky ligj është i dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, më datë 13 dhjetor 2012. Republika e Kosovës i kishte përfunduar procedurat për anëtarësim në Bankën Evropiane për Ndërtim e Zhvillim. Në bazë të veprimtarisë së BERZHIT, është bërë ndryshimi i nenit 1 për plotësimin dhe ndryshimin e marrëveshjes me Bankën Evropiane për Zhvillim e Rindërtim, ku shtohet edhe pjesa e Afrikës Subsahariane, si rajon ku banka mund ta ushtrojë veprimtarinë e vet. Po ashtu, në mënyrë që të ketë fleksibilitet në menaxhimin e limiteve në kapitalin e bankës dhe për këtë është ndryshuar amendamentimi i nenit 12.1 të kësaj marrëveshjeje. Bordit të Drejtorëve të Bankës i caktohen përgjegjësitë që të vendosin dhe të bëjnë kufijtë e kapitalit të BERZH-it. Këto dakordime janë mundësuar nga guvernatorët e Bankës, ku pjesëmarrës janë ministrat e Financave të shteteve anëtare, dhe secili shtet anëtar në banka duhet ta amendamentojë dhe ta ratifikojë këtë amendament në marrëveshjen për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për të reflektuar këto ndryshime. Çdo amendamentim duhet bërë përmes

procedurës së njëjtë për ndryshim-plotësimin e marrëveshjes për themelimin e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të ratifikohet sipas legjislacionit në fuqi të vendit dhe Kushtetutës etj.

Janë dy nene që janë ndryshuar, njëri është për gjeografikimin e vendit e tjetri është për fleksibilitetin e menaxhimit të vendosjes së kufijve të kapitalit të bankës. Miratimi i kësaj marrëveshjeje i shërben Qeverisë së Republikës së Kosovës për realizimin e objektivave në progresin ekonomik dhe rindërtimin. Qëllimi i bankës do të jetë të forcojë tranzicionin drejt ekonomive të orientuara kah tregu i hapur dhe të promovojë iniciativat private dhe ndërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari e vendosi marrëveshjen në votim dhe konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, e miratoi marrëveshjen dhe Kuvendit ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr.08/L-303 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim(“Marrëveshja”) - neni 1.

6. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2025-2027

Kryetari: Në bazë të nenit 19, paragrafi 3.1 të Rregullores së Kuvendit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu sikurse edhe buxheti vjetor, përgatitet nga Administrata e Kuvendit, në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere. Pas shqyrtimit, Komisioni ia dërgon Kryesisë së Kuvendit, rekomandimin dhe më pastaj Kryesia e procedon KASH-in, e Kuvendit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfere, që e njëjta të inkorporohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Republikës së Kosovës për periudhën **2025-2027**. Grupi punues, i formuar më 20.3.2024, ka mbajtur një takim së bashku me përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës, ku është diskutuar KASH-i.

Mirëpo, këtë kërkesë tani nuk kemi pse ta qesim në votim, sepse Qeveria e ka sjellë në Kuvend KASH-in për vitin 2025-2027 dhe kjo është e tejkualuar.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2023

Kryetari: Në bazë të nenit 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për trashëgiminë kulturore, Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin e Këshillit Kosovës për Trashëgimi Kulturor, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe si rrjedhojë, Këshilli duhet t'i raportojë Kuvendit. Lidhur me këtë pikë, kemi ftuar kryesuesen e Këshillit, znj. Zanita Halimi, që të prezantojë dhe të arsyetojë raportin e Këshillit Kosovës për Trashëgimi Kulturor, për vitin 2023.

Zanita Halimi: Ne, si institucion, nuk kemi ndonjë buxhet të madh dhe buxheti total është 230,532 euro dhe ndahet në 3 kategori: paga e mëditje, mallra e shërbime dhe shërbime komunale. Agjencia për Trashëgimi Kulturor, gjatë vitit 2023, ka shpenzuar 88% të buxhetit, mirëpo kemi zhvilluar aktivitete të shumta, të cilat lidhen me fushën e trashëgimisë kulturore. Si fushë kryesore është shqyrtimi i dosjeve të

aseteve për futjen dhe mbrojtjen e tyre që propozon Ministria e Kulturës, së bashku me qendrat rajonale dhe me trashëgimi kulturore. Në fillim të vitit 2021, kemi filluar mandatin dhe për një kohë të gjatë kemi qenë pa bord, i kam rishikuar dhe në vitin 2016 kanë qenë vetëm 23 asete në mbrojtje të përhershme, por me kalimin e kohës i kemi rritur, dhe prej vitit 2016 deri në vitin 2021, janë diku 80 asete në mbrojtje të përhershme. E kemi dërguar në Komision listën te deputetët, për monumentet të cilat janë në mbrojtje ose gëzojnë statusin e mbrojtjes nga Këshilli për Trashëgimi Kulturore. Në paga e mëditjet buxheti i realizuar deri në fund të viti 2023, ka qenë në vlerë 135,579.84 euro, ndërsa pjesa tjetër e mbetur 10,399.26 euro, janë shpallur dy pozita. Këto dy pozita kanë qenë e arkeologut dhe zyrtarit ligjor, por nuk kanë arritur të plotësohen, për shkak se janë hapur konkurset dhe kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet. Në kategorinë mallra e shërbime buxheti ka qenë 81,1993 euro, dhe janë realizuar 86,347 euro, kurse kanë mbetur 15,645 euro. Agjencia, gjatë periudhës 2023, si pjesë e projektit ka qenë “FULL BRAJT”. Këshilli për Trashëgimi Kulturore e ka në mision edhe rishikimin e vendit historik të Prizrenit, me Ligjin për trashëgimi kulturore e në kuadër të Ligjit për qendrën e studimit të Prizrenit, ka arritur bashkëpunim me “WATERITEJQ”, që është pjesë e KOMOS-it, e përfaqësuar nga znj. Branon, e cila ka kontribuar në fushën e trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit. Në raportin e auditimit nuk ka pasur të gjetura dhe jemi konform rregulloreve të ligjit në fuqi.

Jeta Statovci: Faleminderit për raportin e detajuar dhe i keni bashkangjitur edhe vendimet që të kemi një pasqyrë sa më të qartë. Puna me të cilën e bëni ju, është shumë e veçantë, sepse ka të bëjë me identitetin e një populli, si zakonet, traditat, trashëgiminë kulturore e shpirtërore dhe besoj se edhe si punë e ka një ndjesi te veçantë.

Zanita Halimi: Ka pasur shumë material, por kemi menduar se duhet të jetë raporti më i detajuar për ju deputete dhe i kemi bashkangjitur edhe vendimet, sepse ia vlen për t’i parë dhe për të ditur për këtë agjenci, se çfarë vlerash ka e çfarë valorizimesh dhe me qenë transparente, kështu e kam parë më të arsyeshme.

Enver Haliti: Më intereson të di për investime kapitale. Keni kërkuar viteve tjera, por prapë në vitin 2023, keni kërkuar, por nuk keni shpenzuar për investime kapitale. Çfarë investimesh kapitale ju duhen, çka keni dashur të thoni me këtë investime kapitale?

Zanita Halimi: Si Këshill për Trashëgimi Kulturore, s’kemi pasur një herë të vetme një linje për investime kapitale. Pra, kishte për t’iu ndihmuar komunave, por edhe Ministrisë së Kulturës, jo vetëm tek asetet, por edhe te funksionalizimi, edhe hapësirat për muzetë e gjëra të tjera.

Sadik Krasniqi: Desha të shtoj se tek asetete e trashëgimisë kulturore, që janë në listën tonë dhe janë me 83 asete, në vijim, këto asete do të rriten. Sa i përket aseteteve të veçanta, ne i verifikojmë, nëse janë në rrezik ato, duhet intervenuar edhe financiarisht. Kemi jashtëzakonisht raste të mëdha, në lidhje me asetete, dhe si të tilla, është e nevojshme për të shpëtuar një aset të trashëgimisë, qoftë arkeologjik apo ndonjë asset tjetër sipas shtyllave që janë të përcaktuara, që përmes financave, të ndërhyjmë.

Enver Haliti: Po, jam në dijeni, që përmes Ministrisë së Kulturës, janë ndarë këto mjete financiare dhe është fondi emergjent për intervenime në objekte të trashëgimisë kulturore. A ka Këshilli staf, që t’i zhvillojë të gjitha ato procedura? Zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe përzgjedhja e operatorëve

ekonomikë, menaxhimin e projekteve, a e konsideroni se Këshilli ka staf të mjaftueshëm për gjitha këto procedura?

Zanita Halimi: Këshilli për Trashëgimi Kulturore nuk ka mjaft staf, por shpresojmë që të rritet stafi dhe të shtohen edhe detyrat, por kjo ka qenë synimi jonë. Në momentin kur kemi diskutuar për këtë pikë, kemi kërkuar edhe rritjen e stafit, që këto dyja të shkojnë së bashku, paralel.

Kryetari: Në gusht të viti 2022, ka pasur një aktgjykim prej Gjykatës së Apelit, me ish- udhëheqshin e Këshillit për Trashëgimi kulturore, z. Koci. E pretendimi është se nga janari i viti 2018 deri në gusht të vitit 2021, është mbajtur pozita e udhëheqësit ekzekutiv dhe ka fituar pagë prej 45,000 euro, pa i llogaritur udhëtimet të tjera. Desha të pyes, a ka qenë kjo e ligjshme apo jo? Dua t'i kem me shkrim, gjithçka që keni dërguar me shkrim tek organet e drejtësisë. Mirëpo, thuhet se gjatë mandatit te këtij personi është ngritur në pozitë, është bërë udhëheqës i Divizionit për Trashëgiminë Kulturore. Pra, është shkelur rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës, neni 26/2, si dhe Rregullorja e shërbimit civil, neni 14. Në këtë rast, janë shkelur rregullat dhe nuk është përmbushur detyrimi ligjor, dhe i njëjti person e ka vendosur veten në Komisionin pranues, dhe me rregulloren në fuqi, ka bërë shkelje. Nëse ka mundësi, t'i dërgoni me shkrim. A keni bërë klasifikime të reja për këtë vit?

Zanita Halimi: Ne kur kemi ardhur në korrik të viti 2021, jemi ballafaquar me të njëjtën situatë dhe ka qenë momenti që ose t'i shtohet edhe një mandat, se kur kemi ardhur ne, atij i ka skaduar mandati. Për shkak të shumë dilemave, nuk ia kemi vazhduar mandatin. Të gjitha i kemi përcjellë nëpër organe të drejtësisë, si në gjykata dhe tek Agjencia Kundër Korrupsionit, mirëpo nuk kemi marrë përgjigje ende. Në vitin 2021, ka qenë e gjetur nga auditori dhe disa hamendësime tjera dhe të gjitha i kemi dërguar tek organet e drejtësisë dhe nuk e kemi në staf personin në fjalë. Po ashtu, kemi bërë klasifikime dhe ka mbërrirë numri deri në 83.

Kryetari: Ju falënderoj për këtë raport kaq të detajuar! Nëse të kujtohet nga viti i kaluar, që të kam pyetur për klasifikim të përkohshëm e të përhershëm, a ka pasur klasifikime nga i përkohshmi në të përhershmin? A keni ndërmarrë diçka, sa i përket monumentit të minatorëve në Mitrovicë? Tek arkitekti në Rashak, është një kështjellë e vogël ilire, e vjetër, në fshatin Gumnisht është një shpellë. A keni punuar diçka rreth kësaj?

Zanita Halimi: Në Këshillin për Trashëgimi Kulturore ka pasur klasifikime të përkohshme në të përhershme. Prej se kemi ardhur ne si bord, janë bërë 83, dhe 60 kanë kaluar prej të përkohshmit në të përhershmin, nuk mund të kalojë direkt pa qenë e përkohshëm në të përhershëm, sepse kjo është procedura. Monumenti i Minatorëve të Mitrovicës është në të përkohshëm dhe është në rrugë për të përhershëm.

Premtim Alaj: Sa i përket veriut të Mitrovicës, përgjegjës për monumente të arkeologjisë është Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe në pjesë tjera të Kosovës është finalizuar harta arkeologjike e Kosovës. Nuk është vetëm Mitrovica, por duke përfshirë edhe Prishtinën e Podujevën dhe nuk kemi arritur ende ta finalizojmë hartën arkeologjike të Kosovës, as në pjesën veriore Kosovës. Për asetet që i përmendët, janë të njohura. E para ishte e Rashanit, kemi informacione që është një kështjellë e vjetër e arkitektit të shekullit 4 apo 6 pas Krishtit, tjetra e Dubocit që është në Komunën e Vushtrrisë, ka pasur hulumtime vetëm paralufte, dhe ne e kemi trajtuar në mënyrë të veçantë gjatë punimeve tona dhe janë vendbanime më të mira në historinë e Kosovës, nuk kemi mundur të bëjmë më shumë. Lista e trashëgimisë arkeologjike, janë të shënuara 400, mirëpo mund të rritet në 800. Sa i përket Mitrovicës, nuk kemi shumë mundësi në atë zonë.

Kryetari: Pasi që nuk ka kuorum, po e shtyjmë votimin për mbledhjen tjetër.

8. Të ndryshme

Kryetari pyeti anëtarët e Komisionit, se a kane diçka për të shtuar te pika, të ndryshme, meqë nuk pati, e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit